



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 196, Datë 15.08.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 193, DATË 18.09.2024
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HPG ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2239/1 prot., datë 13.08.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 193, datë 18.09.2024, ka licencuar shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në dispozitivin e këtij vendimi, ERE ka vendosur, ndër të tjera se: *shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, jo më vonë se data 16.10.2024 si dhe shoqëria duhet të raportojë në ERE çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik dhe të dokumentojë fillimin e tyre brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, pra brenda datës 18.07.2026, përndryshe duhet të depozitojë në ERE VNM Paraprake të re.*

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Me shkresën nr. 28 prot., datë 30.07.2025, protokolluar në ERE me nr. 2239 prot., datë 30.07.2025, shoqëria “HPG ENERGY” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e kushteve të licencës së miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024, duke kërkuar shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi për fillimin e ushtrimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike deri më datë 16.12.2025, për shkak të vonesave të krijuara nga zgjerimi i nënstacionit elektrik “Hoxharë e Re”, Topojë, Fier dhe zbardhjen e lejes së ndërtimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), e lëshuar më datë 29.05.2025.
- Shoqëria ka njoftuar se punimet për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik kanë përfunduar më datë 18.07.2025 dhe se është në procesin e kolaudit dhe testimit nga Ministria e Infrastrukturës

dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), si dhe në procesin e lidhjes së kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike.

- Në mbështetje të kërkesës, shoqëria ka depozituar kopjen e lejes së ndërtimit të zbardhur nga AZHT, si dhe njoftimet përkatëse të përfundimit të punimeve, të përcjella institucioneve përgjegjëse.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Me shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “HPG ENERGY” sh.p.k., vlerësohet se kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024, është vendosur mbi bazën e deklaramit të shoqërisë në aplikim dhe nuk rrjedh nga një afat ligjor apo kontraktual që mund të ketë përfunduar. Duke qenë se leja e ndërtimit është e vlefshme deri më 28.05.2026 dhe afati i vënies në punë të centralit fotovoltaiik sipas kontratës me MIE nuk është tejkaluar, kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e këtij afati deri më 16.12.2025 vlerësohet e bazuar dhe pika 2 duhet të ndryshohet në përputhje me këtë afat.
- Në kushtet kur shoqëria “HPG ENERGY” sh.p.k. ka përfunduar punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaiik, ka njoftuar organet kompetente për testimin dhe kolaudimin e veprës dhe është në pritje të përfundimit të këtij procesi, detyrimi i parashikuar në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024, për raportim çdo 3 (tre) muaj mbi fillimin e punimeve ka humbur objektin. Si i tillë, ky kusht vlerësohet se duhet të ndryshohet duke përcaktuar detyrimin për depozitimin në ERE të dokumentacionit të testimit të veprës nga organet përkatëse brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, në përputhje me praktikën e vendimeve të ngjashme të bordit të ERE-s.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024, duhet të ndryshohen, pasi shoqëria “HPG ENERGY” sh.p.k. ka përmbushur kushtet përkatëse dhe afatet e reja duhet të reflektojnë situatën aktuale të realizimit të projektit.
- Për sa më sipër pika 2 e vendimit nr. 193/2024, vlerësohet të bëhet: *“2. “Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, jo më vonë se data 16.12.2025”*.
- Ndërsa pika 3 e vendimit nr. 193/2024 vlerësohet të bëhet: *3. “Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës”*.
- Me ndryshimin e pikave 2 dhe 3 të vendimit nr. 193/2024, dispozitat e tjera të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE nr. 193, datë 18.09.2024, ndryshon dhe bëhet: *“2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, jo më vonë se data 16.12.2025.”*

2. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE nr. 193, datë 18.09.2024, ndryshon dhe bëhet:
“3. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.”
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI